




**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**

SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KGJK.nr.451/2022**

**Datë: 24 nëntor 2022**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Rregullores Nr. 11/2022 për Evidencën Penale në Republikën e Kosovës, në mbledhjen 299-të, të mbajtur me datë 24 nëntor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet propozimi që certifikata elektronike e gjendjes penale të nxjerrët pa pagesë për palët kërkuese, kurse të paguhet taksa për tërheqjen e certifikatës së gjendjes penale në formë fizike në gjykatë.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 24 nëntor 2022.

**A r s y e t i m**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 24 nëntor 2022, ka shqyrtuar çështjen e pagesës së certifikatave elektronike (online) që pasqyrojnë të dhënat nga dosja penale, të cilat do të procedohen nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale.

Këshilli me qëllim të digjitalizimit të shërbimeve dhe proceseve brenda gjykatës dhe duke marr parasysh impaktin pozitiv që do të ketë procedimi elektronik i certifikatave të gjendjes penale në lehtësimin e qasjes së palëve në shërbimet e gjykatës, ka vendosur që me rastin e nxjerrjes së certifikatës së gjendjes penale në formë elektronike - online nga sistemi, palët kërkues të marrin këtë shërbim pa pagesë. Sa i përket, tërheqjes së certifikatave të gjendjes penale në formë fizike në gjykata, të paguhet taksa konform rregullave të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

Andaj, nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Gjykatave të Republikës së Kosovës;
- Zyrës Qendrore të Evidencës Penale;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.